



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FUSHE-ARREZ
KESHILLI

Nr. 2796 Prot.

Fushe-Arrez me 04/09/2024

VENDIM
Nr.42 date. 28.08.2024

PER

“ ZGJIDHJE KONFLIKTI PER PROBLEME RRUGEKALIMI NE LAGJEN NDOKAJ NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER FUSHE ARREZ BASHKIA FUSHE-ARREZ.”

Keshilli i Bashkise ne mbledhjen e tij te dates 28.08.2024, bazuar ne ligjin 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54. germa “a”, Rregullores per funksionimin e Keshillit te Bashkise Fushe-Arrez, Ligjit Nr.9780 date 16.07.2007 “Per inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndertimet e kundraligjshme”, neni 3, pika “a”, neni 4, neni 5, vendimit te Keshillit te Bashkise nr.30.date 27.06.2024. “Per ngrtije Komisioni te Perkohshem te Perzier “ Per zgjidhje konflikti per probleme rrugekalimi ne lagjen Ndokaj Njesia Administrative Qender Bashkia Fushe-Arrez” , Relacionin e Komisionit te mesiperm me Nr. 2334 Prot., date 22.07.2024 “Relacion i Komisionit te Perkohshem te Perzier per zgjidhje konflikti per probleme rrugekalimi ne lagjen Ndokaj, Njesia Administrative Qender, Bashkia Fushe-Arrez.” ne baze te kerkeses me Nr.1792 Prot., date 04.06.2024, te Z.Ded Prendi, banor i lagjes se mesiperme. Keshilli i Bashkise pas shqyrtimit te dokumentacionit dhe pretendimeve te paleve ne konflikt :

VENDOSI

1.Te njohe si rrugekalim te ligjshem segmentin e rruges qe lidh rrugen auto ne drejtim te Kishes “Shen Jozefi” me shtepine e Z. Ded Prendi, pasi siperfaqja e tokes nga kalon rruga e siperpermendur eshte e regjistruar ne dokumentet kadastrale dhe hartografike, si “toke shtet” dhe mbeshtetur nga deklaratat e banoreve te kesaj lagjeje se ky segment eshte rruge tradicionale qindravjeçare e lagjes, rruge e perdorur nga banoret e lagjes Ndokaj Njesia Qender Bashkia Fushe-Arrez .

2.Rruga e cilesuar ne piken 1 te vendimit, i bashkangjitet edhe Plani i Rilevimit per Punime Kadastrale, i pergatitur nga eksperti, ku jane te pasqyruara te gjitha te dhenat qe lidhen me kete rruge.

3.Ky segment i rruges te jete e lire dhe lehtesisht i kalueshem , pa presione dhe pa pengesa te çfaredo lloji.

4.Per çdo pengese qe krijohet per perdoruesit e kesaj rruge , te demtuarit duhet tu drejtohen institucioneve ligjzbatuese .

5.Per zbatimin e ketij Vendimi ngarkohen Administrata e Bashkise, Policia Bashkiake, Strukturat drejtuese ne nivel Bashkie dhe ne nivel Komisariati.

Ky vendim u miratua me 15 vota pro
Vota kunder 0 vota
Vota Abstenim 0 vota
Ky vendim u shpall me date 04. 09.2024

SEKRETARI

Tom CURRI



KRYETARI

Nikolin BARDHOKU

